



Diskutim rreth mbetjeve urbane

Përfshirja e banorëve të zonës së Kamzës në gjetjen e zgjidhjeve për menaxhimin e mbetjeve të ngurta



Një shoqëri pa plane koherente për trajtimin e mbetjeve e lë detyrën e seleksionimit të tyre në dorë të atyre që janë të guximshëm të merren me plehrat. Duke influencuar zhvillimin e një plani urban banorët lokalë do të sigurojnë një të ardhme më të mirë.

HYRJE

Në qytetin e Kamzës, në zonat e Bathores dhe të Frutikulturës, të cilat nuk kanë sisteme të menaxhimit të mbetjeve, është krijuar një gjendje papastërtie e rënduar, meqë mbetjet shtëpiake digjen dhe hidhen në kanalet kulluese. Komunitetet vendore, në bashkëpunim me autoritetet e tyre, kanë nevojë të gjejnë zgjidhje të menjëhershme duke përdorur rrugën demokratike të informimit të duhur lidhur me mënyrat më të mira të menaxhimit të mbetjeve.

OBJEKTIVAT

Grupi i punës të projektit pati si qëllim të punonte në problemet e shkaktuara nga mbetjet për:

- të dhënë informacion banorëve sipas parimeve të Konventës së Arhusit;
- të mbështetur banorët dhe organizatat me bazë komuniteti të shkëmbejnë mendimet dhe marrin pjesë në çështjet lidhur me menaxhimin e mbeturinave;



OJF drejtuese
Co-PLAN,
Qendra për Zhvillimin
e Habitatit

Drejtuese e projektit
Sally Kelling
Adresa e kontaktit te OJF-së
Ada Tower,
Rr. Dervish Hima
KP 2995 Tirana, Albania
Tel: (355-4) 257-808/9
Faks: 355-4) 257-807
E-mail: coplan@albnet.net

- t'u paraqitur bashkisë dhe qytetarëve disa metoda të mundshme për zvogëlimin e sasisë së mbetjeve
- të gjetur një zgjidhje të përbashkët, midis komunitetit dhe bashkisë, për problemin e mbetjeve sipas procesit të përshkruar nga Konventa e Arhusit.

METODIKA

Grupi i punës së projektit i arriti qëllimet e tij përmes:

- shpërndarjes, në komunitet, të një pyetësori dhe materialeve të tjera ndërgjegjësuese rreth çështjes së mbetjeve;
- organizimit të mbledhjeve të hapura me komunitetin për të shpërndarë informacion dhe diskutuar zgjidhje të mundshme;
- paraqitjes së rasteve konkrete dhe organizimit të vizitave në vendet ku gjenden depozitime ilegale të mbeturinave;
- zhvillimit të diskutimeve të grupeve të punës për këtë çështje; dhe
- arritjes së marrveshjes së bashkëpunimit ndërmjet përfaqësuesve të autoriteteve vendore dhe komunitetit.

ARRITJET

Grupi i punës arriti që të:

- ndërgjegjësojë banorët për të njohur vetveten si partnerë të rëndësishëm me autoritetet vendore;
- informojë banorët dhe t'i përfshijë ata në përgatitjen e dy planeve lokale për ngritjen e sistemit të grumbullimit të mbeturinave në Bathore dhe Frutikuturë.
- përcaktojë mundësi ripërdorimi të mbetjeve, si pjesë e rëndësishme e sistemit të menaxhimit të mbetjeve, i cili do të zbatohet në të ardhmen.

VAZHDIMESIA

Në të ardhmen, nevojitet vazhdimi i aktiviteteve për ndërgjegjësimin e mëtejshëm të komunitetit për çështjen e ripërdorimit të mbetjeve. Deri tani është përgatitur Plani i Veprimit për t'u përfshirë në Axhendën e zhvillimit të zonës së Bathores, një dokument për zhvillimin e qëndrueshëm fizik, social dhe ekonomik. Ky material është paraqitur përmes botimit në gazetë dhe banorët janë të mirëpritur për të dhënë mendimet e tyre rreth tij. Ai ka qenë objekt debati në TV midis kandidatëve për kryetar bashkie të kësaj zone.



Injorimi i mbetjeve urbane sjell probleme edhe më të mëdha.

